

## LETER E DREJTIMIT

Drejtuar Znj. Semiha Dolani  
Ekspert Kontabel i Regjistruar

Kjo leter e deklarimeve jepet ne lidhje me kryerjen e auditimi tuaj ligjor te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara te Partise Republikane ne fushaten elektorale te vitit 2009, me qellimin e shprehjes se nje opinoni ne se fondet e perfituara dhe te shpenzuara, japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit, specifike e SNA 800

Ne e njohim pergjegjesine tone per paraqitjen e vertete te regjistrave te posaçem ne pajtim me Ligjin nr. 10019, date 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikes se Shiperise" Nenet, 87, 88,89 ,90 dhe 91 si dhe menyren e raportimit financiar te tyre.

Ne konfirmojme, sipas njohurise dhe besimit tone me te mire, deklarimet ne vijim:  
Perfshi ketu deklarimet perkatese per entitetin. Deklarime te tilla mund te perfshijne:

- Nuk kane egzistuar paregulltesi te cilat mund te implikojne Drejtimin ose te punesuarit me nje rol te rendesishem ne kontolle brendshem, qe mund te kene nje efekt material ne regjistrat e paraqitur.
- Ne ju kemi vene ne dispozicion juve te gjitha librat e llogarive dhe dokumentacionin mbeshettes per krijimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre gjate fushates elektorale.
- Ne konfirmojme plotesine e informacionit te dhene ne lidhje me indetifikimin e paleve te lidhura.
- Regjistrat e posaçem nuk kane anomali materiale, perfshire ketu dhe dokumente te paregjistruara.
- Partia ka vepruar ne perputhje me te gjitha aspektet e kerkesave te Ligjit nr. 10019, date 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikes se Shiperise" dhe neneve perkatese te tij , mosrespektimi i te cilave mund te kete efekte materiale ne regjistrat e posaçem. Nuk ekziston asnje papajtueshmeri me kerkesat e autoriteve rregulluese qe, ne rast papajtueshmerie, mund te kete efekt material ne regjistrat e posaçem.
- Nuk ka gjarje te mevonshme tej mbylljes se regjistrave te posaçem, te cilat te kerkojne rregullimin e paraqitjes te regjistrave te posaçem.

Kryetari Partise Republikane

Fatmir MEDIU

Financieri

Suela KOKOSHI

**RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TE AUTORIZUAR  
PËR AUDITIMIN E FONDEVE TE PERFITUARA DHE TE SHPENZUARA  
NGA PARTIA REPUBLIKANE**

**Adresuar: KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE**

Te nderuar zoterinj

Une, Semiha Dollani në cilësinë e Ekspertes Kontabël të Autorizuar (Auditor i pavarur) jam caktuar me urdherin nr. 4110 date 16.09.2009 te Kryetarit te K.Q.Z. Z. Arben Ristani si dhe Kontrates se Sherbimit te dates 18.09.2009, per kryerjen dhe auditimin e fondeve te perfituara e te shpenzuara per fushaten zgjedhore te Partise Republikane.

Ne kemi audituar pasqyrat bashkalidhur qe lidhen me financimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara per fushaten zgjedhore qe fillon ne date 25.05.2009 dhe mbyllet me date 25.06.2009

Pergatitja e ketyre pasqyrave eshte pergjegjesi e drejtusve te Partise Republikane Shqiptare. Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinjon mbi keto pasqyra bazuar ne auditimin tone.

Ne e kryem auditimin tone ne perputhje me Standartet Nderkombetare te auditimit me reference te vecante SNA 800 (raporti i auditorit per angazhime, auditimi me qellime te vecanta).

Keto standarte kerkojne qe ne te planifikojme dhe te kryejme auditimin per te zoteruar siguri te arsyshme, se keto pasqyra nuk permbajne anomali materjale. Auditimi perfshin shqyrtimin, mbi bazen e testeve, te fakteve qe mbeshtesin shumat dhe deklarimet ne pasqyrat financiare te arketim-pagesave.

Auditimi perfshin gjithashtu, vlersimin e parimeve te kontabilitetit te ndjekura dhe vlersimet e rendesishme te bera nga drejtimi, si edhe vlersimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyres arketim-pagesave.

Ne cmojme se auditime yne perben nje baze te arsyshme per te shprehur opinionin tone.

Politika kontabel e ndjekur nga ana e subjektit zgjedhor Partia Republikane eshte te pergatise pasqyrat bashkalidhur mbi bazen e arketimeve dhe pagesave. Mbi kete baze, e ardhura eshte njohur ne montin e arketimit dhe shpenzimet ne momentin e pagesave.

**Per mendimin tone, pasqyrat bashkalidhidhur japin nje pamje te vertete e te singerte te fondeve te arketuara dhe shpenzuara nga subjekti zgjedhor Partia Republikane gjate fushates elektorale qe hapet me 25.05.2009 dhe mbyllet me 25.06.2009, ne perputhje me bazen e arketimeve dhe pagesave, sic pershkruhet ne shenimet bashkalidhur.**

**Raporti u hartua mbeshtetur ne pasqyrat bashkalidhur.**

**Eksperte Kontabel**

**Semiha Dollani**

**Tiranë, më 09.10. 2009**

## **1. TE DHENA TE PERGJITHSHME MBI SUBJEKTIN ZGJEDHOR**

Subjekti zgjedhor "Partia Republikane" e ka fituar zotesine juridike per te vepruar, me vendim Nr.16/2 date 10.01.1991 te Gjykates se Rrethit Tirane.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit Nr. 8788 date 07.05.2001 "Per Organizatat Jofitimpruese" te Ligjit 8779 date 07.05.2001 "Per Rregjistrimi e Organizatave Jofitimpruese", nga statuti i saj dhe legjiacioni ne fuqi.

Subjekti zgjedhor Partia Republikane eshte nje organizate shqiptare e cila e ushtron veprimtarine e saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise. Kapitalit themeltar i Qendres eshte shuma prej 100.000 leke (njeqind mije).

Qendra e shoqerise eshte ne rrugen « Abdi Toptani», Tirane. Kjo shoqeri eshte rregjistruar prane organeve tatimore te rrethit Tirane me numer Nipti K 52428003 L.

### **Objekti i veprimtarise :**

Qellimi i Partise Republikane eshte te forcoje eksperiencen politike demokratike ne Shqiperi duke promovuar vlera demokratike.

### **Burimet e financimit jane:**

-Buxheti i Shtetit 10 695 140 leke

-Donacionet dhe dhuratat 500 000 leke

-Si dhe burime te tjera te ligjshme sipas legjislacionit shqiptar. Zero (0).

Te gjitha burimet financiare do te perdoren drejtpersedrejti per te realizuar qellimet dhe objektivat e subjektit zgjedhor

### **Organet drejtuese te Qenders jane:**

- Asambleja Kombetare;
- Kryetari

Kryetar eshte zgjedhur **Z.Fatmir Mediu**, i cili eshte autorizuar te ndjeke te gjitha procedurat e nevojshme per aktivitetin normal te «Partise Republikane».

## **1. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABEL**

### **a. Menyra e Prgatitjes se Pasqyrave Financiare**

Pasqyrat Financiare jane pregatitur ne te gjitha aspektet e tyre materiale, ne perputhje me Normat Kombetare te Raportimit Financiar (NKRF), te cilat perfshijne rregullat e percaktuara ne ligjin Nr. 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe "Planin Unik Kontabel", te miratuar me vendim te Keshillit te Ministrave.

Pasqyrat e paraqitura ne raport jane shprehur ne monedhen vendase ne Leke.

### **b. Rregullat per vleresimin e kerkesave per arketim dhe te detyrimeve**

Kerkesat per arketim jane te pasqyruara mbi bazen e vleres se faturave origjinale te leshuara nga klientet apo te dokumentave te tjere kontabel.

Detyrimet jane njohur dhe pasqyruar mbi bazen e faturave dhe dokumentave orgjinale kontabel.

### **c. Rregullat e vleresimit te likujditeteve**

Gjendjet e likujditeteve perfshijne gjendjen e parave ne arke dhe ne llogarite rrjedhese ne banke ne leke.

U kontrolluan veprimet e kryera ne arke dhe banke dhe u konstatuan se rregjistrimet ne librat e llogarive dhe ne ditaret perkates ishin kryer sipas normave kontabel. Terheqet nga banka perputheshin me hyrjet ne arke.

### **d. Te Ardhurat**

Te ardhurat regjistroheshin sipas mases se realizimit te tyre nga dontoret dhe perdorimi i tyre eshte sipas planit te buxhetit te financiar.

## **ORGANIZIMI I KONTABILITETIT**

Kontabiliteti eshte i organizuar ne perputhje me ligjin "Mbi Kontabilitetin".

**PASQYRA E TE ARDHURAVE TE PARTISE REPUBLIKANE**

| <b>NR</b> | <b>PERSHKRIMI I DHURIMIT</b> | <b>VLERA TE LEK</b> | <b>IDENTITETI I PLOTE I DHURUESIT</b> | <b>DATA E DHURIMIT</b> | <b>NR. LLOG</b> |
|-----------|------------------------------|---------------------|---------------------------------------|------------------------|-----------------|
| <b>I</b>  | <b>Nga buxheti i shtetit</b> |                     |                                       |                        |                 |
| 1         | KQZ                          | 10695140            | KQZ                                   |                        |                 |
|           |                              |                     |                                       |                        |                 |
|           | <b>TOTALI I</b>              | <b>10695140</b>     |                                       |                        |                 |
|           |                              |                     |                                       |                        |                 |
| <b>II</b> | <b>Nga persona fizike</b>    |                     |                                       |                        |                 |
| 1         | Donacion                     | 100000              | Gjergji Miculi                        | 05.06.2009             | Arke            |
| 2         | Sponsorizim                  | 100000              | Dashnor Bajaziti                      | 15.06.2009             | Arke            |
| 3         | Financim per fushate         | 100000              | Asrit Veliaj                          | 17.06.2009             | Arke            |
| 4         | Sponsorizim                  | 100000              | Myrvete Pazaj                         | 18.06.2009             | Arke            |
| 5         | Sponsorizim                  | 100000              | Luan Duzha                            | 18.06.2009             | Arke            |
|           | <b>TOTALI II</b>             | <b>500000</b>       |                                       |                        |                 |
|           | <b>TOTALI I+II</b>           | <b>11195140</b>     |                                       |                        |                 |

EKSPERTE KONTABEL Semiha DOLLANI

PASQYRA E SHPENZIMEVE TE PARTISE REPUBLIKANE

|                          |                   |
|--------------------------|-------------------|
| <b>FINANCIMI NGA KQZ</b> | <b>10.695.140</b> |
| <b>SPONSORIZIME</b>      | <b>500.000</b>    |
| <b>TOTALI</b>            | <b>11.195.140</b> |
| <b>SHPENZIME</b>         | <b>13.147.971</b> |

| SUBJEKTI                | FATURA                                 | SHUMA                  | NR.MAND: | DATA             | SHUMA                  | Likujduar |           | PA LIKUJ.           | LLOJI I SHERBIMIT                  |
|-------------------------|--|------------------------|----------|------------------|------------------------|-----------|-----------|---------------------|------------------------------------|
|                         |  |                        |          |                  |                        | ME ARKE   | ME BANKE  |                     |                                    |
| EDISUD RADIO-TV MEDIA 6 | 329 DT.15.06.2009<br>244 DT.15.06.2009 | 1.078.300<br>3.135.600 | 398 460  | 20.06.2009       | 1.078.300<br>3.135.600 | 1.000.000 |           | 78.300<br>3.135.600 | SPOT PUBLICITAR<br>SPOT PUBLICITAR |
| MEDIA VIZION            | 266 DT.16.06.2009                      | 1.285.000              | 391      | 18.06.2009       | 500.000                |           | 500.000   |                     | SPOT PUBLICITAR                    |
| MEDIA VIZION            | 266 DT.16.06.2009                      |                        | 405      | 22.06.2009       | 500.000                |           | 500.000   |                     | SPOT PUBLICITAR                    |
| MEDIA VIZION            | 266 DT.16.06.2009                      |                        | 456      | 26.06.2009       | 285.000                | 285.000   |           |                     | SPOT PUBLICITAR                    |
| MEDIA VIZION            | 305 DT.26.06.2009                      | 177.150                | 452      | 26.06.2009       | 177.150                | 177.150   |           |                     | SPOT PUBLICITAR                    |
| METRO                   | 135 DT.12.06.2009                      | 513.590                |          |                  | 513.590                |           | 250.000   | 263.590             | REKLAME                            |
| ORA                     | 11 DT.26.06.2009                       | 290.000                | 462      | 26.06.2009       | 290.000                | 290.000   |           |                     | SPOT PUBLICITAR                    |
| ORA                     | 12 DT.27.06.2009                       | 270.000                | 469      | 27.06.2009       | 270.000                | 270.000   |           |                     | SPOT PUBLICITAR                    |
| ORA                     | 123 DT.30.06.2009                      | 198.200                | 484      | 30.06.2009       | 198.200                | 198.200   |           |                     | SPOT PUBLICITAR                    |
| ORA                     | 13 DT.28.06.2009                       | 280.000                | 473      | 28.06.2009       | 280.000                | 280.000   |           |                     | SPOT PUBLICITAR                    |
| ORA                     | 14 DT 29.06.2009                       | 280.000                | 478      | 29.06.2009       | 280.000                | 280.000   |           |                     | SPOT PUBLICITAR                    |
| PLATEA                  | 129 DT. 12.06.2009                     | 1.015.171              |          |                  | 1.015.171              | 500.000   | 500.000   | 15.171              | REKLAME                            |
| QENDRA SPORTIVE         | 096 DT.18.06.2009                      | 200.000                | 106      | 18.06.2009       | 200.000                | 200.000   |           |                     | QERA SALLE                         |
| RADIO BE-94             | 3 DT.16.06.2009                        | 46.800                 | 384      | 16.06.2009       | 46.800                 | 46.800    |           |                     | SPOT PUBLICITAR                    |
| TOP CHANNEL             | 694 DT.26.06.2009                      | 2.500.000              |          |                  | 2.500.000              |           | 2.500.000 |                     | SPOT PUBLICITAR                    |
| TV BALLKAN              | 220 DT.26.06.2009                      | 44.000                 | 458      | 26.06.2009       | 44.000                 | 44.000    |           |                     | SPOT PUBLICITAR                    |
| UNIVERS REKLAMA         | 931 DT.14.09.2009                      | 1.089.160              |          | 30.06A23.0<br>9B | 1.089.160              | 589.160   | 500.000   |                     | BANER/POSTER                       |
| WICK                    | 22.06.2009                             | 745.000                | 399      | 22.06.2009       | 745.000                | 745.000   |           |                     | FLAMUJ                             |
|                         |  | 13.147.971             |          |                  | 13.147.971             | 4.905.310 | 4.750.000 | 3.492.661           |                                    |

EKSPERTE KONTABEL Semiha DOLLANI

## **LETËR ANGAZHIMI**

*PER AUDITIMIN E PASQYRES SE ARKETIM - PAGESAVE (fondet e përfuara dhe shpenzuara për fushatën zgjedhore)*

### **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

***Rruga "Deshmoret e Kombit" Pallati i Kongreseve***

TIRANE.

#### **Objekti**

Ju keni kerkuar qe une e nenshkruara Semiha Dollani me cilesine e EKA me license profesionale 129 te IEKA, te auditoj FONDET E PERFTUARA DHE TE SHPENZUARA PER FUSHATEN ZGJEDHORE nga subjekti zgjedhor "Partia Republikane Shqiptare", sipas proceduarave te miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, per periudhen zgjedhore te vitit 2009. Te mbyllur ne daten 25.06.2009. Une ju konfirmoj se e pranoj dhe e kuptoj kete angazhim nepermjet kesaj letre. Auditimi do te kryhet me objektivin per te shprehur nje opinion per pasqyren e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara per fushaten zgjedhore nga subjekti zgjedhor, "Partia Republikane Shqiptare" në përputhje me Ligjin nr. 10019, date 29/12/2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Ligjin nr. 10091, datë 05/03/2009 "Për Auditimin Ligjor, Organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Rregjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar", dhe Ligjit nr. 9228, date 29/04/2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat Financiare"

Pergjegjesia:

Ju kujtoj se pergjegjesia per pergatitjen e pasqyrave; Libri i llogarive të Subjektit Zgjedhor, Rregjistri i posaçëm, miratuar si model me vendim të KQZ-së, si dhe pasqyra e Arketim – Pagesave (fonde te akumuluar dhe shpenzuara per fushaten zgjedhore nga subjekti zgjedhore i me siperme) të cilat janë mbajtur për të pasqyruar gjithë transaksionet financiare në lidhje me fushatën zgjedhore dhe qe japin bazën për përgatitjen e Pasqyrës së arkëtim – pagesave, si dhe gjithë informacionet e tjera kontabile etj ne sherbim te ketyre pasqyrave eshte pergjegjesi e drejtuesit te subjektit "Partia Republikane Shqiptare".

Gjithashtu, drejtuesit e subjektit zgjedhore "Partia Republikane Shqiptare" janë përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e programeve dhe kontrolleve për të parandaluar dhe zbuluar mashtrimet, si dhe të na informojnë ne për mashtrimet e njohura ose të dyshuara në subjekt, të cilat përfshijnë:

- (1) drejtuesit;
- (2) punonjësit që kanë rol të rëndësishëm në kontrollin e brendshëm; dhe
- (3) të tjerë ku mashtrimi ka një efekt material në pasqyrat financiare.

Drejtuesit janë përgjegjës për të na informuar për dijeninë e tyre për deklaratat për mashtrim ose të ndonjë mashtrimi të dyshuar në parti të bërë nga punonjesit aktuale, punonjës të mëparshëm, ose të tjerë. Si pjesë e procesit të auditimit, ne do të kërkojmë nga drejtuesit, konfirmim me shkrim në lidhje me paraqitjet e bera për ne, përsa lidhet me auditimin. Pra, ne do të kërkojmë që drejtuesit të na japin një deklaratë ku pranojnë përgjegjësitë e drejtuesve të tyre në përgatitjen e pasqyrave financiare, duke konfirmuar disa konfirmime që na kanë bërë ne gjatë punës sonë të auditimit. Përgjigjet e këtyre pyetjeve dhe deklaratimet me shkrim të kërkuara nga SNA janë pjesë e evidencave mbi të cilat, ne si E.K.A., do të bazohemi që të

japim opinionin tonë për pasqyrat financiare të arkëtim – pagesave

Qellimi:

Une, do te kryej Auditimin ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit (SNA) me referencë të veçantë IAS 800 (raporti i auditorit për angazhime auditimi me qellime të veçanta). Keto standarte kerkojne, qe une te planifikoj dhe te kryejme auditimin per te marre siguri te aresyeshme ne se pasqyrat financiare nuk kane anomali materiale. Auditimi perfshin shqyrtimin, mbi bazen e testeve, te evidencave qe mbeshtesin shumat dhe informacionet e dhena ne pasqyrat financiare.

Audimin gjithashtui perfshin vleresimin e parimeve kontabel dhe cmuarjet e rendesishme te bera nga drejtuesit, si dhe vleresimin e pergjithshem te paraqitjes se pasqyrave financiare.

Raportet:

Pervec raportit tim per pasqyrat financiare sa me siper, une parashikoj tju paraqes edhe nje leter te vecante ne lidhje me ndonje dobesi materiale ne sistemet e kontabilitetit dhe te kontrolleve te brendshme, te cilat do te verehen nga une, e cila eshte leter per Drejtimin e subjektit zgjedhor.

Kufizimet:

Per aresye te natyres se Auditimit mbi bazen e testeve dhe kufizimeve te tjera te vetvetishme te auditimit, sebashku me kufizimet e tjera te vetvetishme te sistemeve te kontabilitetit dhe te kontrolleve te brendshme, ka nje rrezik te pashmangshem qe edhe disa anomali materiale te mbeten te pazbuluara.

**Eksperte Kontabel e Autorizuar**

**SEMIHA DOLLANI**